



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

ORGANIZATA “DREJTËSI SOCIALE”



Nr. 1993 Prot
Tiranë, më 11 . 09 .2025

Nr. extra Prot
Tiranë, më 11 . 09 .2025

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Midis

ORGANIZATËS “DREJTËSI SOCIALE”

DHE

DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Preambul

Ky Memorandum bashkëpunimi lidhet midis:

Organizatës Drejtësi Sociale, organizatë jo-fitimprurëse, e themeluar sipas ligjeve të shtetit Shqiptar me NIPT: M11509454Ë, me qëllim të veprimtarisë së saj, ofrimin e ndihmës ligjore, advokimin në mbrojtje të të drejtave të njeriut, në adresën: Rruga Riza Cerova, Nr. 23, 1010, Tiranë, e përfaqësuar nga z. Gentian Sejrani, Drejtor ekzekutiv.

Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, institucion publik në varësi të Ministrisë së Drejtësisë me seli në Tiranë, i përfaqësuar nga zj. Patricia Pogaçe, Drejtor i Përgjithshëm (*i komanduar*).

Në vijim të quajturat Palë:

- ✓ *Duke patur parasysh*, objektin e veprimtarisë të palëve të këtij memorandumi;
- ✓ *Duke marrë në konsideratë*, bashkëpunimin mes institucioneve vendore dhe qendrore dhe organizatave të shoqërisë civile për rëndësinë integritit dhe përfshirjes së pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane;
- ✓ *Duke vlerësuar*, rëndësinë e realizmit të projekteve të ndryshme me impakt social me fokus pakicat kombëtare rome dhe egjiptiane;
- ✓ *Duke theksuar*, rolin e rëndësishëm të ndërveprimit dhe krijueshmërisë së ndërhyrjeve të qëndrueshme,

Palët kanë rënë dakord të nënshkruajnë sot, më datë 11/09/2025, këtë memorandum bashkëpunimi, në vijim i quajtur *Memorandumi*.

Neni 1 BAZA LIGJORE

Ky memorandum bazohet në Ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe në Ligjin nr. 8788/2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar

Neni 2 QËLLIMI

Qëllimi i këtij Memorandumi është:

1. Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Organizatës “*Drejtësi Sociale*” në funksion të ofrimit sa më të gjerë dhe cilësor të shërbimeve të ndihmës juridike falas.
2. Nxitja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për të drejtën e tyre për të përfutuar ndihmë juridike falas.
3. Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta informuese, edukative dhe trajnimit mbi aksesin në drejtësi dhe mbrojtjen e të drejtave themelore.

Neni 3 OBJEKTI I MEMORANDUMIT

Palët do të bashkëpunojnë për:

1. Organizimin e aktiviteteve informuese në komunitet për të drejtën e ndihmës juridike falas.
2. Ofrimin e këshillimit ligjor dhe mbështetjes për grupet në nevojë.
3. Hartimin dhe shpërndarjen e materialeve ndërgjegjësuëse.
4. Shkëmbimin e informacionit dhe praktikave për përmirësimin e aksesit në drejtësi.

Neni 4 ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E PALËVE

1. **Organizata “Drejtësi Sociale”** angazhohet të:
 - Bashkëpunojë në ofrimin e këshillimit ligjor dhe mbështetjes për qytetarët.
 - Organizojë aktivitete me komunitetet lokale për informimin mbi të drejtat ligjore.
 - Të mbledhë dhe të përcjellë raste konkrete që kanë nevojë për ndihmë juridike falas pranë Drejtorisë së Përgjithshme.
2. **Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas** angazhohet të:
 - Sigurojë koordinimin institucional për ofrimin e ndihmës juridike falas.
 - Vendosë në dispozicion materialet dhe informacionin e nevojshëm.
 - Mbështesë organizimin e aktiviteteve informuese dhe trajnimeve të përbashkëta.

Neni 5 KOMUNIKIMI MES PALËVE

1. Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion për përmbushjen e detyrave të tyre.
2. Palët angazhohen të jenë të disponueshme në çdo kohë për komunikim dhe koordinimin me njëra tjetrën me qëllim koordinimin e veprimeve që duhen të ndërmerren rast pas rasti.

Neni 6
PERSONAT E KONTAKTIT

Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet. Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje personat e kontaktit janë si vijon:

Të dhënat e kontaktit për Drejtorinë e Ndihmës

Juridike Falas

Personi i kontaktit: Z. Suela Qevani

E-mail: suela.qevani@drejtesia.gov.al

Të dhënat e kontaktit për Drejtësi Sociale

Personi i Kontaktit: z. Gentian Seriani

E mail: socialjusticeal@gmail.com

Personat e kontaktit do të jenë përgjegjës për komunikimet sipas këtij Memorandumi. Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e kontaktit pala do të njoftojë me shkrim palën tjetër brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, me të dhënat e personit të ri të kontaktit.

Neni 7
VLERËSIMI I ZBATIMIT

Palët bien dakord të vlerësojnë në mënyrë periodike rezultatet e arritura nga ky bashkëpunim dhe të përcaktojnë hapa të mëtejshëm.

Neni 8
KOHËZGJATJA

Ky memorandum zbatohet për periudhën Shtator 2025 – Dhjetor 2027, me mundësi rinovimi me marrëveshje të përbashkët.

Neni 9
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumu zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.
2. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale, nga një kopje për secilën palë.

Neni 10
HYRJA NË FUQI

Ky memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij.

NËNSHKRIMET E PALËVE

DREJTORIA E NDIHMËS
JURIDIKE FALAS

ORGANIZATA “DREJTËSI
SOCIALE”

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

DREJTOR EKZEKUTIV

(i komanduar)

Zj. Patricia Pogace

Z. Gentian Sejrani

